



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, ~~27~~ 08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 14.08.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "KS BESA SECURITY" për aktivitetin : "**Sigurimi i objekteve te Komunes**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

### VENDIM

1. Aprovohet pjesërisht ankesa e Operatorit Ekonomik "**Besa Security**" e datës 14.08.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sigurimi i objekteve te Komunes**", me Nr.616 19 3238 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,të dates 09.08.2019 te publikuar ne Platformen we KRPP-se-E Prokurimi.
2. Pezullohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë ~~09.08.2019;~~ 09.08.2019.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin ta kthej ne rivleresim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Opratori Ekonomik "**Beaa Security**" me datë 14.08.2019 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : "**Sigurimi i objekteve te Komunes**". Autoriteti Kontraktues, me datë 19.08.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës.Pretendimi i tij ka të bëjë se pari me çmimin e dhene per ore pune nga i propozuari per dhenje te kontrates.Ky pretendim eshte i bazuar pasiqe nje çmim i tille per ore pune nuk mundeson pagesen e pagave dhe te gjitha obligimeve ligjiore te parapara me Ligjin e Punes,si qe eshte kerkuar ne Dosjen e tenderit dhe ne sqarimet e kerkuara nga OE-ik te interesuar per pjesemarrje ne kete aktivitet;

-Pretendimi tjetër ka të bëjë me disa kontrata të cilat sipas pretenduesit nuk mund të pranohen pasi që janë të pa perfunduara nuk është i bazuar pasi që komisioni gjatë vlerësimit ka kërkuar sqarime lidhur me të njëjtat dhe ka konstatuar se janë kontrata të pranueshme.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit